

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6847
E hënë, 13 mars 2023
çmimi 0.40

Ukraina thotë se
Rusia humbi mbi 1 000
ushtarë për 24 orë në
luftën për Bahmutin | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME I GREQISË, NIKOS DENDIAS,
PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË | FAQE 4-5

KOSOVA KËRKON PËRKRAHJEN E GREQISË PËR ANËTARËSIM NË INSTITUCIONE EUROATLANTIKE



Ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Dendias, ka ardhur të dielën për vizitë në Kosovë. Ai është takuar me ministrën e Jashtme, Donika Gërvalla, e cila e ka pritur në Aeroportin e Prishtinës, ndërkaq ka zhvilluar takim

edhe me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Gjatë takimit u diskutua për përparimin e Kosovës në fushën e ekonomisë dhe të sundimit të ligjit, për procesin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Serbinë si

dhe për proceset e integritetit të Kosovës në strukturat euroatlantike. Përfaqësuesit e institucioneve të vendit tonë kanë kërkuar që mbështetja greke për anëtarësimin e Kosovës në institucionet euroatlantike të vazhdojë

AKTUALE



MUNGESA E VENDKALIMIT PO
RREZIKON QYTETARËT NË
VETERNIK | F. 6

SPECIALIZANTËT
PARALAJMËROJNË PROTESTË
KUNDËR SHSKUK-së | F. 3

CRAMON: SHPRESOJ TË KETË
MARRËVESHJE NË OHËR,
DO TË ISHTE HAP I MADH
DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN
PËR TË DY VENDET | F. 5

EKONOMI



BANORËVE TË ZHVENDOSUR NGA
HADJA U KËRKOHET TË PAGUAJNË
TATIM PËR ISH-PRONËN | F. 5

PRISHTINA
BËHET ME
KAMERA
SIGURIE



FAQE 7

KURTI: MARRËVESHJA
BAZË NË MES TË
KOSOVËS E SERBISË,
AVANCIM DREJT
NJOHJES SË
NDËRSJELLË



FAQE 5

SPORT



KAMPIONI FITON KUNDËR
PRIZRENASVE, RAHOVECI ARRIN
FITOREN E KATËRT | F. 12

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina thotë se Rusia humbi mbi 1 000 ushtarë për 24 orë në luftën për Bahmutin

KIEV, 12 MARS - Ushtria ukrainase njoftoi më 12 mars se pala ruse humbi më shumë se 1 000 trupa në 24 orët e fundit teksa përpjekjet e Moskës për qytetin lindor të Bahmutit vazhduan. Kievi tha se është i vendosur ta mbrojë këtë qytet. Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës tha më 12 mars se rusët kanë humbur 1 090 ushtarë dhe tetë tanke në 24 orët e fundit. Një raport i inteligjencës britanike dhe analistë të tjerë perëndimorë thanë se pala ruse ka humbur shumë trupa, teksa synon rrethimin dhe pushtimin e Bahmutit. Komandanti i forcave tokësore të Ukrainës, Oleksandr Syrskiy,

tha se mbrojtja kokëfortë e Bahmutit "është e nevojshme për të blerë kohë, për të ndërtuar rezerva dhe për të nisur një kundërofensivë e cila nuk është larg". "Mediazona", një media e pavarur kundër Putinit, tha se 1 638 ushtarë të rregullt rusë dhe mercenarë kanë vdekur në dy javët e fundit të luftimeve në Ukrainë, një nga periudhat më vdekjeprurëse të konfirmuara për forcat e Putinit. Një ditë më parë Ukraina tha gjithashtu se ushtria ruse nisi "më shumë se 100 sulme" përgjatë vijës së frontit. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, paralajmëroi

më 8 mars se qyteti i shkatërruar ukrainas, Bahmut, mund të bjerë në duart e rusëve në ditët në vijim, pasi ky qytet lindor për muaj të tërë po përballet me luftime intensive. Ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka thënë më 7 mars se kapja e Bahmutit do të ishte hap kyç për nisjen e një ofensive më të gjerë në rajonin e Donjeckut. Luftimet përreth Bahmutit kanë qenë luftimet më të gjata dhe më të ashprat që kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022. Ekspertët perëndimorë kanë thënë se Bahmuti ka më pak rëndësi strategjike për Rusinë sesa rëndësi simbolike.



Senati francez miraton reformën për pensione të Macronit

PARIS, 12 MARS - Me 195 vota për dhe 112 kundër, senati francez ka miratuar planin e reformës për pensione të presidentit Emmanuel Macron. Dispozita kryesore e këtij projektligji është rritja e moshës së daljes në pension nga 62 në 64 vjeç. Dhoma e lartë e parlamentit francez votoi për reformën pas ditës së shtatë të protestave mbarëkombëtare kundër këtij plani. Shumica e qytetarëve janë kundër reformës së propozuar, sipas sondazheve të opinionit publik. Projektligji pritet të shqyrtohet më 15 mars nga komisioni i përbashkët i përfaqësuesve të dhomës së ulët dhe të lartë të parlamentit.



Nëse komiteti bie dakord për tekstin, një votim përfundimtar në të dyja dhomat mund të bëhet të

enjten, por rezultati i votimit mbetet i pasigurt në dhomën e ulët, Asamblenë Kombëtare, ku partisë së Macronit i duhen

votat e aleatëve për ta krijuar shumicën. Nëse qeveria vlerëson se nuk ka vota të mjaftueshme në dhomën e ulët, është e mundur që teksti të shtyhet përpara pa votim parlamentar. Aleanca e qendrës e Macronit ka humbur shumicën parlamentare vitin e kaluar, megjithatë përbën ende grupin më të rëndësishëm në Asamblenë Kombëtare. Përndryshe, qeveria mund të shfrytëzojë një kompetencë të veçantë për ta kaluar ligjin pa votim, por një veprim i tillë do të vinte me çmimin e kritikave të mëdha. Qeveria synon ta miratojë projektligjin deri në verë në

mënyrë që ndryshimet të hyjnë në fuqi në shtator. Greva dhe protesta të tjera në të gjithë vendin janë planifikuar për të mërkurën, më 15 mars, kur pritet shqyrtimi i projektligjit. Franca ka moshën më të ulët të kualifikimit për pension shtetëror në mesin e ekonomive më të mëdha evropiane. Pensioni mesatar është 1 400 euro në muaj pasi të zbriten taksat. Qeveria ka thënë se ndryshimet janë të nevojshme për të garantuar të ardhmen e financimit të sistemit pensional, që pritet të kalojë në deficit në vitet e ardhshme për shkak të plakjes së popullsisë.

Roja bregdetare: Shpëtohen mbi 1 000 migrantë, arrijnë në portet italiane

ROME, 12 MARS - Më shumë se 1 000 migrantë, të vendosur në tri varka të cilat ishin të mbipopulluara, u sollën të sigurt në dy porte italiane, ka bërë me dije një roje bregdetare. Shpëtimet erdhën në të njëjtën ditë kur u zbulua trupi i viktimës së 74-t pas përmbajtjes së një varke me migrantë në Itali gati dy javë më parë. Viktima është një vajzë e moshës rreth pesëvjeçare. Tragjedia e fundit me migrantë në Itali, e cila ndodhi më 26 shkurt në brigjet e Kalabrisë, ka ngjallur kritika të ashpra ndaj qeverisë së krahut të djathtë të udhëhequr nga kryeministrja Giorgia Meloni për dështimin e saj për të ndërhyrë në kohë për

ta shpëtuar varkën. Roja bregdetare tha të shtunën se pas një operacioni të madh shpëtimi që filloi të premten, u shpëtuan mbi 1 000 migrantë, ku tri varka u zunë duke u larguar nga brigjet në jug të Italisë. Varka e parë kishte 487 migrantë në bordin e saj, të cilët, sipas rojës, u sollën në mënyrë të sigurt në portin Crotona rreth orës 02:00 të mëngjesit të 11 marsit. Në varkën e dytë ishin rreth 500 migrantë të tjerë në portin e Reggio Calabria. Ndërsa varka e tretë kishte 379 persona, të cilët u shpëtuan nga dy varka patrullimi të rojës bregdetare dhe migrantët u transferuan në një anije të marinës që drejtohej në portin sicilian Augusta.

Kryeministrja italiane në shkurt kishte shprehur "pikëllim të thellë" për përmbajtjen e varkës dhe ishte zotuar se do t'i japë fund migrimit të parregullt detar si mënyrë për të parandaluar më shumë tragjedi. Ajo më pas u kishte dërguar një letër liderëve evropianë duke u kërkuar veprim të shpejtë për ta zgjidhur problemin afatgjatë të kontinentit me migrantë. Vitin e kaluar Organizata Ndërkombëtare për Migrim në raportin e saj të fundit, tha se më shumë se 29 000 njerëz kanë vdekur teksa kanë tentuar të migrojnë në Evropë prej vitit 2014. Mbi 5 000 viktima janë regjistruar vetëm në dy vjetët e fundit.



Specializantët paralajmërojnë protestë kundër ShSKUK-së

PRISHTINË, 12 MARS - Anulimi i kujdestarive nga ana e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka ngjallur reagimin e specializantëve të cilët kanë paralajmëruar një protestë për ditën e hënë. Arsyeja e kësaj proteste, sipas tyre, është për ta kundërshtuar vendimin e ShSKUK-së, e cili, sipas tyre, është në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së

Kosovës për kompensimin për kujdestari, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit. "Nesër, të hënë, nga ora 10:30, do të mbahet protestë e specializantëve para administratës qendrore të ShSKUK-së. Protesta është njoftuar dhe aprovuar nga shërbimi policor i Kosovës. Do të jenë prezentë specializantë nga 22 klinika ndërsa një klinik ka dalë kundër. Parashihet që

me qenë prezent pra rreth 500 specializantë. Arsyeja e protestës është anulimi i kujdestarive shtesë nga ShSKUK-ja me datë 01.03.2023 dhe detyrimi për të punuar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të marrë me datë 03.02.2023 - rregulloren QRK Nr 7/2023", thuhet në njoftimin për medie.



Propozohet shtrenjtimi i faturave të mbeturinave, qytetarët kundër

PRISHTINË, 12 MARS - Qytetarët e rajonit të Prishtinës së shpejt mund t'i paguajnë faturat e mbeturinave me çmim të rritur. Aktualisht, faturimi për largimin e mbeturinave është tarifë fikse prej 4.7 eurosh. Nga Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" thonë se janë rritur ndjeshëm kostot e operimit, prandaj shtrenjtimi i këtij shërbimi është i domosdoshëm. Po ashtu, thonë se mund të rishikohen edhe pagat e punëtorëve. Kundër këtij propozimi janë qytetarët, të cilët thonë se jeta e tyre është vështirësuar tej mase. Zëdhënësjja e "Pastrimit", Arbnore Ademi, ka thënë për "KosovaPress" se janë kompani me vetëfinancim, prandaj duhet t'i rritin çmimet për t'i përballuar

shpenzimet. "Kompania 'Pastrimi' për kryerjen e shërbimit të pastrimit për largimin e mbeturinave ka kosto shumë të lartë dhe duke e ditur faktin që jemi ndërmarrje me vetëfinancim, nënkupton që të gjitha të ardhurat i sigurojmë përmes pagesave të qytetarëve. Njëkohësisht, në çdo produkt ka rritje të çmimit, ka inflacion dukshëm në vendin tonë, pastaj rritja e derivateve, rritja e pjesëve për kamionë rezervë dhe çdo produkti tjetër ka rritje. Në anën tjetër, pagat e punëtorëve nuk kanë lëvizur dhe faturat e mbeturinave mbeten të njëjta. Duke u nisur nga këto fakte të përmendura, e kemi parë të nevojshme të bëhet kërkesë për rritje të faturave", u shpreh Ademaj.



Vendimi për rritjen e çmimit të faturës së mbeturinave duhet ta

marrë miratimin e kuvendeve komunale të komunave të rajonit

të Prishtinës të cilat i mbulon "Pastrimi".

Haxhiu, kërkesë Serbisë: Të transferohen në Kosovë dy kosovarët që po mbahen në burgjet serbe



PRISHTINË, 12 MARS - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka treguar se ka bërë kërkesë në autoritetet e drejtësisë në Serbi, që dy qytetarë kosovarë të transferohen në Kosovë. Haxhiu ka thënë se është fjala për Nezir Mehmetaj dhe Petrit Dula, të cilët po mbahen në Serbi, mbi pretendimet për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile në Kosovë gjatë vitit 1999. "Javën e kaluar kam kërkuar nga Ministri e Drejtësisë në Serbi që dy qytetarët tanë t'i transferojë në Republikën e Kosovës. Nezir Mehmetaj dhe Petrit Dula mbahen në Serbi mbi pretendimet për kryerjen e krimeve të luftës kundër

popullatës civile në Kosovë gjatë vitit 1999", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

E para e Drejtësisë ka shtuar se procesi i deritanishëm ndaj dy qytetarëve të Republikës së Kosovës është i përbërë nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut për vite të tëra. "Z. Mehmetaj dhe z. Dula janë qytetarë të Kosovës, pra edhe nën mbrojtjen e Republikës. Procesi i deritanishëm ndaj dy qytetarëve të Republikës së Kosovës është i përbërë nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut për vite të tëra. Çdo akuzë ndaj tyre për krimet e pretenduara duhet trajtuar nga organet e drejtësisë në Republikën e Kosovës", ka theksuar Haxhiu.

Shtohen nënoficerët në FSK

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka njoftuar se janë shtuar nënoficerët në radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). "Shtohen nënoficerët-liderë të certifikuar të togjeve në radhët tona!", ka shkruar

Mehaj, duke njoftuar se krahas Kursit për Sniper, në KDS është përmbyllur me sukses të lartë edhe certifikimi i një gjenerate të re me realizimin e Kursit të Avancuar të Liderit. "Ky kurs realizohet mbi bazën e

modelit të edukimit të Ushtrisë Amerikane dhe ka për qëllim zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e aftësive profesionale të nënoficerëve për Udhëheqës togu dhe Rreshter togu", ka shtuar Mehaj.





MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME I GREQISË, NIKOS DENDIAS, PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

Kosova kërkon përkrahjen e Greqisë për anëtarësim në institucione euroatlantike

Ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Dendias, ka ardhur të dielën për vizitë në Kosovë. Ai është takuar me ministren e Jashtme, Donika Gërvalla, e cila e ka pritur në Aeroportin e Prishtinës, ndërkaq ka zhvilluar takim edhe me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Gjatë takimit u diskutua për përparimin e Kosovës në fushën e ekonomisë dhe të sundimit të ligjit, për procesin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Serbinë si dhe për proceset e integritetit të Kosovës në strukturat euroatlantike. Përfaqësuesit e institucioneve të vendit tonë kanë kërkuar që mbështetja greke për anëtarësimin e Kosovës në institucionet euroatlantike të vazhdojë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 MARS - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur të dielën në Kosovë ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Dendias. Gjatë

takimit të tyre u diskutua për përparimin e Kosovës në fushën e ekonomisë dhe të sundimit të ligjit, për procesin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Serbinë si dhe për proceset e integritetit të Kosovës në strukturat euroatlantike.

Në vazhdim ata diskutuan edhe për marrëdhëniet shumë të mira

në mes të Kosovës dhe Greqisë dhe për potencialin e madh për thellimin dhe zgjerimin e këtyre marrëdhënieve. Në takimin e tyre doli vlerësimi i përbashkët për ta rritur bashkëpunimin mes dy vendeve, duke besuar se ky takim do të shërbejë për t'i forcuar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Greqisë dhe për të kontribuar në stabilitetin dhe zhvillimin e rajonit tonë.

Ministrin e Jashtëm grek e ka pritur edhe presidentja Vjosa Osmani, e cila ka vlerësuar angazhimin proaktiv të Greqisë në rajonin tonë, si dhe mbështetjen e vazhdueshme të shtetit grek për integritimin e rajonit në Bashkimin Evropian. Në këtë frymë, presidentja Osmani, duke u thirrur në vlerat e përbashkëta euroatlantike, ka kërkuar që mbështetja greke për anëtarësimin e Kosovës në institucionet euroatlantike të vazhdojë. Ndër të tjera, Osmani ka theksuar se integritimi i plotë ndërkombëtar i Kosovës, përfshirë Bashkimin Evropian, NATO-n dhe

Këshillin e Evropës, do t'i kontribuonte paqes së qëndrueshme në rajon.

Më tutje, presidentja Osmani e ka falënderuar ministrin Dendias për mbështetjen e Greqisë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, për votimin e fundit të Këshillit të Bashkimit Evropian si dhe për avokimin e vazhdueshëm për t'i dhënë fund këtij procesi. Në takim është diskutuar edhe për raportet Kosovë - Greqi, me ç'rast presidentja Osmani ka shprehur gatishmërinë e thellimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve dyanëshe, duke përmendur nevojën e rritjes së shkëmbimit tregtar e ekonomik, si dhe bashkëpunimit në sfera të ndryshme të interesit të përbashkët.

Në lidhje me zhvillimet e fundit në procesin e dialogut me Serbinë, presidentja Osmani ka theksuar se plani i zbatimit të marrëveshjes duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës, e cila do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit afatgjatë në rajon,

gjersa ka ritheksuar se koordinimi i Kosovës me aleatë në këtë proces do të vazhdojë.

Edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pasur një drekë pune me ministrin e Jashtëm të Greqisë, Nikos Dendias, i cili po zhvillon vizitën e gjashtë të tij në Kosovë.

Diskutuan për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe perspektivat për avancimin, themelimin dhe fuqizimin e tyre. Kryeministri Kurti i shprehur edhe një herë ngushëllime ministrin Dendias dhe popullit grek për jetët e humbura në aksidentin tragjik që ndodhi në Greqi në javën e parë të marsit. Ata folën për zhvillimet e fundit në vend dhe rajon, për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe për propozimin evropian për Marrëveshje Bazë. Me këtë rast kryeministri Kurti e njoftoi ministrin Dendias për takimin e 27 shkurtit në Bruksel dhe pritjet e Kosovës nga takimi i 18 marsit në Ohër të Maqedonisë së Veriut.



Kurti: Marrëveshja bazë në mes të Kosovës dhe Serbisë, avancim drejt njohjes së ndërsjellë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se beson se marrëveshja bazë në mes të Kosovës dhe Serbisë është një avancim drejt njohjes së ndërsjellë mes dy shteteve. “Besojmë se normalizimi i plotë i marrëdhënieve kërkon një njohje të ndërsjellë në qendër të marrëveshjes si dhe respektim për të drejtat e minoriteteve në të dy shtetet”, tha ai në një videomesazh të dërguar në edicionin e 11-të të Forumit të Mannheimit, organizuar nga iniciativa e studentëve të

Universitetit Mannheim në Gjermani, i cili u publikua nga Qeveria e Kosovës më 12 mars.

Më 27 shkurt në Bruksel palët u pajtuan për propozimin e BE-së, të titulluar “Marrëveshje drejt normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë”.

Kurti deklaroi pas takimit se ai ishte i gatshëm ta nënshkruante këtë marrëveshje menjëherë, por presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk ishte i gatshëm. “Shpresoj që refuzimi i Serbisë për ta nënshkruar propozimin në Bruksel nuk është indikacion se ajo nuk pajtohet me përmbajtjen. Çdo ditë ne demonstrojmë kreativitetin e

konstruktivitetin tonë”, tha Kurti në videon e 12 marsit.

Vuçiqi ka deklaruar se ai vërtet nuk ka dashur ta nënshkruajë këtë marrëveshje. Ai ka folur më shumë për planin e implementimit.

Më 2 mars, një zyrtar i Bashkimit Evropian, gjatë një takimi me gazetarë, tha se Kurti propozoi që dokumenti të nënshkruhet, por përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, bëri të qartë se BE-ja nuk e ka menduar kështu takimin sepse, sipas tij, marrëveshja duhet të përfshijë edhe aneksin me afatet kohore për implementimin e saj. Sipas tij, Kosova dhe Serbia duhet t'i

nënshkruajnë si dokumente të pandara propozimin evropian dhe aneksin ose planin e zbatimit.

Dokumenti prej 11-nenesh që u bë publik nga BE-ja nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë që Qeveria e Kosovës ka thënë se duhet të jetë në qendër të një marrëveshjeje eventuale për normalizim të raporteve. Megjithatë, në nenin 2 të propozimit thuhet se palët duhet ta respektojnë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetres. Propozimi, po ashtu, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet

e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese.

Raundi i ri i dialogut është caktuar të mbahet më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut dhe, sipas BE-së, qëllimi kryesor tani është që palët të arrijnë pajtim rreth një plani si dhe modaliteteve për zbatimin e propozimit evropian.

Që nga viti 2011 Kosova dhe Serbia zhvillojnë negociata për arritjen e normalizimit të plotë të raporteve nën ndërmjetësimin e BE-së.



Cramon: Shpresoj të ketë marrëveshje në Ohër, do të ishte hap i madh drejt integritimit evropian për të dy vendet

PRISHTINË, 12 MARS - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon, shpreson për një marrëveshje në mes të Kurtit dhe Vuçiqit në Ohër më 18 mars.

Cramon, e cila e ka shpërndarë shkrimin e ambasadorit gjerman Jorn Rohde në “Twitter”, ka thënë se arritja e një marrëveshjeje do të ishte një hap i madh drejt integritimit evropian për të dy

vendet. “Shpresoj shumë që do të shohim të dyja nënshkrimet në marrëveshje në fund të javës së ardhshme në Ohër. Do të ishte një hap i madh drejt integritimit evropian për të dy vendet”, shkroi Von Cramon. Ndërkaq, Rohde ka deklaruar se mbështet plotësisht përpjekjet e emisarit të BE-së, Miroslav Lajçak, për dialogun Kosovë - Serbi.

Rohde në një postim në “Twitter”

ka shkruar se nuk duhet humbur “autobusi”, por të veprohet në konstruktivitet. “Kosova do të fitojë shumë. Kosova duhet ta zbatojë detyrimin e saj të gjatë dhe ta përmbushë themelimin e Asociacionit tani. Apeli im për Kosovën dhe Serbinë për bisedimet e ardhshme në Ohër është: ‘Mos e humbisni autobusin’, ka shkruar ambasadori gjerman.



Prishtina po bëhet me kamera sigurie

PRISHTINË, 12 MARS - Komuna e Prishtinës, së bashku me Policinë e Kosovës, përmes një projekti do të vendosin kamera të sigurisë në udhëkryqet si dhe mbi semaforët. Për vendosjen e tyre janë ndarë 450 mijë euro. Projekti pritet të fillojë të realizohet në pjesën e dytë të

këtij viti. Sipas drejtorit të Shërbimeve Publike, Ilirik Musliu, këto do të shërbejnë për vetëdijesimin e qytetarëve të cilët ngasin makina me shpejtësi të madhe. Kamerat do t'ia bëjnë të qartë komunës se në cilat udhëkryqet duhet të ndryshojë minuzatza

e semaforëve për ta bërë qarkullimin e veturave më të lirë që të mos krijohet kolona. Sipas ekspertit të komunikacionit, Nol Deda, një projekt i tillë është më së i nevojshëm dhe është dashur të ndërmerret kohë më parë. Këtë po e mirëpresin edhe banorët e kryeqytetit.



Mungesa e vendkalimit po rrezikon qytetarët në Veternik

PRISHTINË, 12 MARS - Rruga që shpie nga Prishtina në drejtim të Gjilanit, saktësisht në lagjen në Veternik në Prishtinë, paraqet rrezik të madh për qytetarët, ngaqë një pjesë e tyre përgjatë ditës kalojnë mbi pengesa për të dalë në anën tjetër të rrugës, sepse nuk ka vendkalim për këmbësorë.

E numri i aksidenteve që ndodhin në këtë rrugë nuk është i vogël shkaku i mungesës së mbikalimit apo nënkallimit të cilat shihen si zgjidhje për këtë rrugë.

Eksperti i komunikacionit, Bekim Ahmeti, ka thënë se organet kompetente është dashur të ndërhyjnë sa më parë në rrugën në Veternik dhe jo të pritët që të ndërtohet një mbikalim.

Ahmeti tha se në dhjetë vjetet e fundit, si pasojë e aksidenteve, kanë humbur jetën 1 317 persona, që është quajtur "Dekada e përgjakshme". "Në mungesë të mbikalimit ndodhin aksidentet për arsye se në të dyja anët e rrugës ka biznese që duhet të ndërlihen mes vete gjatë tërë ditës, por edhe natën. Si rezultat i kësaj është dashur që

organet kompetente të ndërhyjnë sa më parë dhe jo të pritët që të ndërtohet një mbikalim, pastaj për rreth 10 kilometra mos të ketë më asnjë ndërtim fare dhe gjendja të jetë e mjerueshme. Arsyeja veç po dihet, që këmbësorët nuk kanë mundësi të lëvizin prej njëres anë në anën tjetër të rrugës dhe, si rezultat, po ndodhin aksidentet. Për dhjetë vjetet e fundit i kemi 1 317 viktima. Ka qenë dekadë e përgjakshme. Si rezultat kryesor ka qenë pikërisht shpejtësia e lartë e lëvizjes", u shpreh Ahmeti. Sipas tij, zgjidhja për këtë rrugë është dashur të bëhet atëherë kur kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës dhe jo, sipas tij, të merren masa kur të ndodhin aksidentet.

Eksperti i komunikacionit nënvizoi se vendosja e vendkalimit për këmbësorë në këtë rrugë nuk është zgjidhje. Zgjidhja e vetme, sipas tij, është mbikalimi ose nënkallimi. "Zebra nuk bën sepse kjo është rrugë nacionale. Nuk ka mundësi për zebra. Në qoftë se i vendosim zebra, duhet t'i shoqërojmë me sinjalizimin vertikal dhe ka



mundësi edhe të mos i respektojnë ngasësit. Zebra zakonisht nuk bëhen në rrugë nacionale dhe regjionale. Mbikalim dhe nënkallim, nuk ka mundësi tjetër", potencoi ai. Në muajin maj të vitit 2020 është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet ish-ministrit të Infrastrukturës dhe Ambientit,

Lumir Abdixhiku dhe ish-kryetarit të Prishtinës, Shpend Ahmetit, në të cilën në fokus ka qenë ndërtimi i mbikalimit për këmbësorë në lagjen Veternik.

Kanë kaluar gati tri vjet dhe punimet për ndërtimin e këtij mbikalimi ende nuk kanë nisur. Në njoftimin për kontratë të publikuar

nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është bërë me dije se ky ndërtim do të kushtonte mbi 1 milion euro.

Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndodhur 28 aksidente trafiku me të lënduar dhe 31 aksidente trafiku me dëme materiale. (kps)

Dëmtohet kalldrëmi në Çarshinë e Vjetër në Gjakovë



GAJKOVË, 12 MARS - Çarshia e Vjetër në Gjakovë është pazari më i vjetër në Kosovë. Pazari i vjetër ishte zemra e ekonomisë në Gjakovë, në qytetin e tregtisë dhe të mallrave, i cili u shërbeu fshatrave përreth komunës së

Gjakovës, zonës së Junikut dhe zonës malore të Gjakovës (Malësia e Gjakovës) në kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Çarshia e vjetër është djegur dhe shkatërruar gjatë luftës së vitit 1999, më

pas u rindërtua në

stilin e njëjtë. Shumë prej tyre sot shërbejnë si kafene.

Prej të gjithë atyre zejtarëve që kanë punuar aty tani kanë mbetur vetëm

pak, të cilët kanë trashëguar zanatin nga të parët e tyre. Mirëpo këto ndryshime janë të ndikuara edhe nga infrastruktura.

Kalldrëmi historik që e ka karakterizuar këtë vend është

dëmtuar me kalimin e viteve, duke prishur edhe imazhin e vendit historik. Fotografi i "Telegraf"-it, Korab Basha, ka kapur disa nga pamjet ku vërehet dëmtimi i infrastrukturës historike të Çarshisë së Vjetër në Gjakovë.

Qytetari raporton se prej dy muajsh mungon ndriçimi publik në lagjen Dardania në Prizren

PRIZREN, 12 MARS - Mungesa e ndriçimit publik në zonat e banuara vazhdon të paraqesë problem për qytetarët në shumë qytete të Kosovës. Në

disa qytete të tjera ekziston infrastruktura, mirëpo organet komunale nuk reagojnë me kohë për rregullimin e llambave të

prishura. Një gjë e tillë është raportuar edhe në qytetin e Prizrenit.

Një qytetar që ka dashur të mbesë anonim ka raportuar

në platformën ndreqe.com se prej dy javësh në lagjen Dardania në Prizren ndriçimi publik mungon për shkak të prishjes së llambës.



Banorëve të zhvendosur nga Hadja u kërkohet të paguajnë tatim për ish-pronën



PRISHTINË, 12 MARS - Banorët e fshatit Hade e Re ende janë duke paguar tatim prone për vendin ku dikur jetonin para se të shpërnguleshin nga viti 2002 e këndeje nga fshati. Hadja është një nga fshatrat në komunën e Obiliqit që i përket zonës së shpallur me interes të veçantë për zgjerimin e aktiviteteve minerare të Korporatës Energjetike të Kosovës - KEK. Në këtë zonë gjenden rezerva të qymyrit - burimit më të rëndësishëm energjetik të Kosovës, i cili furnizon rreth 97 për qind të prodhimit total të energjisë elektrike.

Nebih Shala, Ruzhdi Mirena dhe Sh. P. janë që të tre banorë të Hades të cilët kanë qenë pjesë e projektit të zhvendosjes. Që të tre janë duke banuar në Hade të Re por, përveç kësaj, ata kanë edhe një gjë tjetër të përbashkët si shumica e banorëve tashmë të zhvendosur: Që të tre banorëve u është kërkuar të paguajnë tatim edhe për pronën ku dikur jetonin e që më nuk ekziston në emër të tyre.

Nebih Shala, banor i Hades së Re, i cili njëherësh është edhe zyrtar i Gjendjes Civile në komunë të Obiliqit, tregoi për "Radion Evropa e Lirë" se kompensimet për pronë i janë bërë në vitin 2011, të cilat bëhen nga KEK-u dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Sipas tij, qeveria i ka kryer procedurat, ndërsa KEK-u e ka bërë pagesën. "Në vitin 2011 mua më është bërë pagesa për shpronësim dhe në vitin 2012 më ka ardhur [njoftimi] që jam i ngarkuar me tatim... Ne kemi dalë në vitin 2012, sepse na kanë larguar nga Hadja dhe kemi qenë diku dy vjet si në [gjendje] emergjente në banesë në Obiliq derisa e kemi ndërtuar shtëpinë këtu... Kompensimi është bërë në fund të vitit 2011... Për ish-pronën, për 2012 kur unë kam qenë i shpronësuar më kanë mbetur edhe 38 euro tatim në pronë dhe ai borxh nuk është shlyer dhe nuk kam ndër

mend ta paguaj fare, sepse unë nuk kam jetuar aty më 2012... Të gjithë kanë borxhe, shumicës i kanë mbetur borxhet e Hades atje", u shpreh Shala për REL.

Kur u pyet nga "Radio Evropa e Lirë", zëdhënësi i KEK-ut, Skender Bucolli, lidhur me këtë çështje, tha: "Duhet pyetur në komunë për atë se ne nuk e dimë". Në anën tjetër, drejtori i Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrës në komunën e Obiliqit, Arben Berisha, konfirmoi për "Radio Evropa e Lirë" se pas inicimit të çështjes së shpronësimit, ata janë në pritje të një takimi në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për të kaluar në fazën e bartjes së pronave. "Realiteti është ai që po e thoni ju [banorët ende paguajnë tatim prone edhe pas shpërnguljes]... E kemi inicuar këtë çështje me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor për arsye se nuk e kanë sjellë dokumentacionin komplet të shpronësimit dhe të ndërrimit të pronarëve, nga pronarët privatë në pronarë Qeveria e Republikës së Kosovës... Po presim çdo kohë që Ministria të na dërgojë komplet lëndët, [pastaj] ne hymë në aparat kadastral dhe e bëjmë bartjen e pronave", tha Berisha për REL.

"Radio Evropa e Lirë" e ka pyetur Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me atë se a është e vërtetë që banorët paguajnë tatim edhe për ish-pronën pasi janë zhvendosur, mirëpo deri në publikimin e këtij teksti REL nuk ka marrë përgjigje. Shpronësimet dhe zhvendosjet nga këto zona kanë nisur që nga viti 2002, ato kanë nisur nga institucionet e atëhershme të përkohshme, më pastaj kanë vazhduar edhe nga Qeveria e Kosovës më 2009, kur edhe është shpallur Zonë e Interesit të Veçantë Ekonomik.

Zëdhënësi i KEK-ut, Bucolli, në një prononcim më herët për REL-in,

kishte thënë se nga viti 2002 deri në vitin 2013 nga fshati Hade janë larguar rreth 127 familje dhe janë shpronësuar 156 hektarë tokë.

Ruzhdi Mirena, tashmë banor i Hades së Re, tregoi për "Radion Evropa e Lirë" se në tetor të vitit 2020 kanë nënshkruar kontratë me KEK-un, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën e Obiliqit, pastaj për vitin 2020 dhe vitet në vijim, 2021 dhe 2022, u është kërkuar të paguajnë tatim prone, ani pse ai është tashmë i zhvendosur. "Ne kemi shkuar në komunë [kemi pyetur] se si ne kemi nënshkruar kontratën dhe na ka ardhur faturimi për pagesë. Na ka ardhur çdo vit [nga viti që jemi zhvendosur] fatura për të paguar [tatim], edhe pse me marrëveshje ka qenë për të na liruar nga të gjitha tatimet", u shpreh Mirena për REL.

Të njëjtin problem e ka edhe banori Sh. P. i cili është zhvendosur nga Hadja në vitin 2004, dhe ai për "Radion Evropa e Lirë" e cilësoi këtë situatë si neglizhencë nga institucionet kompetente. "Trojet nuk ekzistojnë dhe kërkohet tatimi për to... Trualli im nuk dihet se ku është... kjo është moskryerje e punëve të tyre. Unë kam qenë njëherë, ka figuruar tatimi 19 euro, personat me të cilët kam biseduar, ata njerëz [kanë thënë] që iu figuron tatimi në pronë", u shpreh banori i Hades për REL-in. Sipas një hulumtimi të realizuar nga Paneli i Inspektimit të Bankës Botërore në vitin 2016, për projektin e Termocentralit Kosova e Re thuhet se banorët kanë thënë se kanë pësuar humbje toke, mjete të jetesës. Sipas hulumtimit, një pjesë e banorëve kanë thënë se është zhvendosur me detyrim nën një Plan të Veprimit për Zhvendosje, i cili nuk ka qenë në pajtueshmëri dhe gjatë më shumë se një dekadë ata kanë pësuar varfërim, kanë mbetur pastrehë, janë përballur me mungesë të ushqimit, mungesë

të tokës dhe papunësi.

Në hulumtim thuhet se menaxhmenti i bankës shpjegon se asnjë projekt i mbështetur nga banka në sektorin e minierave dhe energjisë në Kosovë nuk ka kërkuar zhvendosje dhe, gjithashtu, pranon se praktikat e kaluara të zhvendosjes në Kosovë që janë bërë para angazhimit të bankës kanë pasur ndikime negative mbi popullatën e prekur.

Qeveria e Kosovës kishte nënshkruar në fund të vitit 2017 marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane 'Contour Global' për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re me kapacitet 500 megavatë, i cili do të kushtonte 1.3 miliard euro. Mirëpo, në vitin 2020, me një njoftim për medie, kompania tregoi se ky projekt nuk mund të realizohet për shkak të kundërshtimit të ndërtimit të këtij termocentrali nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, asokohe në mandatin e parë.

Sipas Panelit të Inspektimit, që nga viti 2004 Hadja është ndarë në tri pjesë duke i shkaktuar dëme

komunitetit si tërësi dhe tri nëngrupeve të popullsisë së saj në këtë mënyrë: ata që ishin evakuuar më 2004/05, të prekurit nga zhvendosja e pavullnetshme nga Shala në vitin 2012 dhe personat e të tjerë, e ardhmja e të cilëve, sipas Panelit të Inspektimit, është e pasigurt. "Gjithsej 158 familje me 664 persona i janë nënshtruar evakuimit emergjent më 2004/05. Kjo përfshiu një grup prej 30 familjeve të dëbuara me forcë nga ana e autoriteteve në atë kohë. Përderisa këto familje pranuan kompensimin, nuk u realizua as vlerësimi i pavarur për nivelet e kompensimit e as monitorimi sistematik i gjendjes së tyre nga asnjë institucion", thuhet në hulumtim.

Visar Mirena, banor i Hades, tha për REL se "para shpronësimit kur i kemi nxjerrë herën e fundit certifikatat e pronave, na ka ardhur që kemi borxh, a ne realisht kemi qenë të liruar nga borxhet. Këtu ka mospërputhje me atë që është marrë vendim dhe me atë që kanë vepruar".

Çfarë ndodh nëse nuk paguhet tatimi?

Në rast të mospagesës së detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit, në doracakun për pyetje/përgjigje të Administratës Tatimore të Kosovës, thuhet se ATK-ja do t'i ndërmarrë të gjitha masat që janë të parapara me legjislacionin tatimor, ku do të kalohet në procedurat e Mbledhjes së Detyrueshme.

Me mbledhje të detyrueshme nënkuptohet se Administrata Tatimore e Kosovës ka autorizime të shumta, të cilat janë të parapara me ligjet tatimore, si: kërkimi i informatave për pasurinë si nga tatimpaguesit, ashtu edhe nga palët e tjera duke përfshirë bankat, regjistrimin e barrës tatimore (në tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme).

Mbledhja e detyrueshme nënkupton edhe: bllokimin e llogarive bankare dhe konfiskimin e mjeteve në to, bllokimin dhe konfiskimin e mjeteve të pritura nga klientët apo punëdhënësit, bllokimin e mallrave për import apo eksport, moslejimin për largim nga Kosova, konfiskimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme (me përjashtim të gjësëndeve themelore për jetesë të familjes), shitjen e pasurisë së konfiskuar, ndjekjen penale etj.



NËN PËRKUJDESJE TË UDHËHEQËSIT ALI AHMETI U ORGANIZUA PROMOVIM MODEL PËR KOMBIN SHQIPTAR



Ismet SYLEJMANI

Në Shkup nën përkujdesjen e Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti e në organizim të ITSHKSH, u bë promovimi i librit: "Ilegalja shqiptare – pararendëse e rrënimit të Jugosllavisë"! Isha i nderuar që isha i ftuar nga Zëvendës Kryeministri i Parë i Maqedonisë së Veriut miku im Artan Grubi, të merrja pjesë në këtë eveniment të madh që do të mbahet mend e do të mbetet i shënuar, si një nga promovimet më të mëdha për shqiptarët në Ballkan!

Çdo ditë e më shumë që po

kalon, por edhe që do të kalojë, do të bindemi me fakte se krahas rolit të madh e të padiskutueshëm të ilegales shqiptare në rrënimin e Jugosllavisë, roli i madh dhe i padiskutueshëm i shokut e bashkëveprimtarit tim Ali Ahmeti, shqiptarit më të madh të shekullit që po jetojmë, ka qenë rol kardinal në sukseset e mëdha të Lëvizjes Popullore të Kosovës, e cila nën udhëheqjen e Tij u bë themelueses se UÇK-së, UÇKombëtare, e cila bashkë me tri ushtritë ishte dhe mbeti determinuesja dhe flamurtarja e proceseve të mëdha të betejave, fitoreve dhe çlirimit të popullit shqiptar nën ish-Jugosllavi!

Abaz Gjuka njëri prej dirigjentëve më të mëdhenj të ilegalës shqiptare, dhe dirigjent fantastik të luftës për liri e çlirimit e të jetës së lirë e demokratike të popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, ishte dhe mbetet



emblema dhe modeli më i përkryer i shqiptarit më besnik ndaj interesave të popullit, Atdheut dhe Kombit të tij! Për herë të parë njëri prej themeluesve të tri ushtrive çlirimtare, Dielli i Galaktikës shqiptare në Maqedoninë e Veriut Ali Ahmeti, deklaroi se: "... Gjeneralët që na jepnin mësim nga Shqipëria, dinin edhe foletë e dallendysheve në kazernat e Jugosllavisë...!" Për të shtuar se: "... Edhe ne i kemi ditur të gjithë dallendyshtet për bashkëpunor të UDB-së që janë dhe çdo kush

që fluturonte në çdo aeroportet e Europës, mbrenda 24 orësh ne e dinim ku është dhe çka bën...!" Në atmosferë imponante, në mes dhembjesh e lotëve, të ngritjes në këmbë nga të pranishmit dhe duartrokitjeve te gjata në shenjë nderimi e respekti, u dorëzuan dosje për Simbolin e Rezistencës Adem Demaçi, për Gjeneralin Legjendar të UÇK-së, Heroin e Kombit Fehmi Lladrovci, për veprimtarin e madh të popullit shqiptar, ish-të burgosurin politik Tahir Hani dhe për

shqiptar të tjerë atdhetar me kontribute të mëdha për kombin! Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, deklaroi se do të ndriqohet me llupë gjithëçka! Me fakte e argumente do të demaskohen jo vetëm armiq e tradhëtarët, por edhe fallsifikatorët dhe mashtruesit, të cilët nuk kanë lënë gurë pa lëvizur e mjet pa përdorur, për të denigruar lëvizjen politiko-patriotike për çlirim, pavarësi e demokraci të shqiptarëve në ish-Jugosllavi!

Prishtinë, 12 Mars 2023!



Proza poetike nga Sali Bashota



GJËRAT E PARËNDOMTA

Atë ditë asgjë nuk ngjante me gjërat që i kishte adhruar në fëmijëri. Sytë tashmë e shikonin botën ndryshe. Thoshin se fati i fëmijës është i lidhur në kërthizë sepse aty mpleksej periudha e vajit. Disa ëndërronin bashkë me periudhën e kohëzgjatjes së puthjeve prej nga vinte parandjenja për buzëqeshjet e sapoformuara të cilat i jepnin shpirt asaj ndjesie të bukur për të cilën kishte treguar vazhdimisht Rrëfimtari i çasteve të dehura. Askush nuk kishte ndër mend të mendonte më shumë për ta vërtetuar këtë fakt.

Shiu i imët tashmë e zbulonte misterin ku riprodhohej kujtesa për mëkatit e dashurisë. Buzët e asaj vajze e kërkonin vetëm afshin e përsosur të reagimeve në atë sfond të kaltër, ku përshkruhej zhvendosja e kuptimeve në një ëndërr simbolike, derisa dridhej tërë hapësira përreth. Prandaj ngjashmëria me gjërat e parëndomta ia ngjallte oreksin për ta kuptuar më mirë lumturinë e vërtetë sesi do të bëheshin bashkë dëshirat e njerëzve të vetmuar në këtë botë.

Disa ditë më vonë Rrëfimtari të çasteve të dehura i ra ndër mend ta kuptonte arsyen e vërtetë për ta mbërritur qëllimin përfundimtar, se ku fillonte dhe ku mbaronte kënaqësia e syve. Me një fjalë, a kënaqej syri derisa e zotëronte hapësirën e shikimit për t'i lidhur ndjenjat përbrenda dëshirës dhe vullnetit.

– Dashuria për vetveten është emri i një mallkimi, – tha Rrëfimtari i çasteve të dehura. Sigurisht nuk gjeti fjalë më të duhur për ta shprehur inatin ndaj gjërave të parëndomta dhe pas pak ndjeu edhe një dhimbje të fortë në shpirt. Asgjë më shumë.

LUMTURIA E PËRSOSUR

– Nuk duhet të imagjinojmë më, – tha një ditë gruaja që i shtrinte rrobat e bardha në ballkonin e ndërtesës së vjetër. Ajo zakonisht gjithmonë rrinte me gojë mbyllur dhe sikur mijëra mendime vlonin në kokën e saj. Kjo qe intuita e parë e Rrëfimtari të çasteve të dehura derisa i përpunonte të dhënat për

lojën e ngrohtë të ndjenjave, sidomos pasionin për t'i dëgjuar rrëfimet e imagjinuara të dashurisë. Sigurisht duhet trajtuar me kujdes praninë e lumturisë së përsosur, sidomos përfytyrimin e arsyes, pse njeriu ka nevojë të mburret me mirësinë e shpirtit. Për shembull, si do të arrinin në majën e asaj kodrine duke pëshpëritur vetëm fjalë të mira apo duke zënë me dorë dehjen e ëndrrave të bukura, ndonëse ngrohtësia e përshëndetjeve nuk kishte të bënte aspak me harrimin, as me etjen e fshehur në lojën e mashtrimit. Kur e mbaroi krejt rrëfimin, sikur u shndërrua në një njeri tjetër.

BOTA AREALE

– Nuk duhet t'i imitojmë më instinktet e pabarabarta të shpirtit, – tha ditën tjetër gruaja që mendonte ndryshe nga shitësja e luleve në qytetin e rrethuar me blirë. U zgjua dhe i preku me dorë xhamat e avulluar të dritareve. Humbi përpara avullit dhe filloi t'i fërkonte sytë. Nuk shihte asgjë tjetër pos vetvetes. Aty fillonte fundi i pritjes. Ngadalë nisi letërkëmbimin me Rrëfimtarin e çasteve të dehura, pa e vlarë mendjen se gjysmën e gishtërinjve i kishte të mpirë nga lodhja.

– Nuk e di si mund të përplasen ndjenjat dhe mendimet në këtë botë, – pëshpëriste prapë në vetvete. Përballë dritares shikonte kalimtarët e rastit të cilët ecnin duke i bartur kujtimet e tyre deri në drejtimin e panjohur.

Disa orë më vonë bota areale filloi t'i lëvizte kujtimet. Pikërisht kështu dhe ndodhi.

HIDHËRIMI

– Kurrë nuk do ta kuptojmë hidhërimin, – tha pa menduar mirë, sepse ishte i ngazëllyer nga prania e dalldisjes së ndjenjave, apo sepse virtyti njerëzor i kishte mbetur në kujtesë derisa i numëronte të gjitha gjethet e asaj luleje të vyshkur atë ditë vjeshte, kur i jepte këshilla vetvetes për gjërat që kishin mjaft rëndësi për të vërtetën. Asgjë më shumë. Asnjë hollësi tjetër.

Atë ditë për të parën herë e kuptonte se Rrëfimtari i çasteve të dehura e kishte mësuar aq mirë

instinktin e vardisjes sa që nuk kishte fare nevojë për medaljen e mosmirënjohjes, as të shndërrohej në tjetër njeri. Trurin e kishte të turbulluar, sytë e përgjumur, ecjen e shkujdesur, ndërsa veprimin e pamatur. Asgjë më shumë. Asnjë hollësi tjetër.

– Nuk dua asgjë prej dhimbjes sime, – mermëriti në vetvete Zana derisa prapë iu turbullua mendja. E kapi frika e panjohur. Çdo gjë iu kthye mbrapsht. Sytë e saj të bukur. Fytyra e saj e ndezur. Shikimi i saj i magjepsur.

Asgjë më shumë. Asnjë hollësi tjetër.

INTRIGA E MREKULLUESHME

– E dashur, në orën sa duhet ta mbyllim rrëfimin për ëndrrat e bukura. Në orën sa, fiks?

Më dukej se ishte një sens humori, pikërisht në pjesën e dytë të mendimit, sepse aty fiksohej orari i saktë i ritualit të mallëngjimit për gjërat e bukura të cilat tashmë e kishin humbur kuptimin. Pastaj vazhdonte rrëfimi për zmadhimin e emocioneve, për temat që afirmonin vuajtjen e shpirtit të dielave në mbrëmje, kur ndjesia e zemrave bëhej më e qartë në zbërthimin e realitetit.

Prapë e pyeti pothuajse me të njëjtin zë: – E dashur, në orën sa duhet ta mbyllim rrëfimin për ëndrrat e këqija?

Asnjëri nuk mund ta dallonte përmasën e zotërimit të shkakut pse shumica e të pranishmëve mendonte se dashuria është gjithmonë e bukur, si një nuse që u jep ujë dasmorëve të etur të cilët harrojnë ta dallojnë fantastikën nga realiteti apo çastin e përdezur nga ora e gjumit në ditët më të pazakonshe, kur sajohej përfytyrimi i saktë për gjërat e bukura.

IKJA E VUAJTJES

Nuk do ta përfytyrojmë më botën tjetër, – tha kur filloi t'i mësonte përmendsh të gjitha vuajtjet e shpirtit.

Vuajtja e parë kërkonte një studim të dyfishtë midis mëkatit dhe dashurisë.

Nuk dinin çka bënin. Vështronin.

Nuk gjenin asnjë fjalë që ua ngacmonte ndjenjat e humbura. Vështronin dalldisjen e ngutshme të gishtërinjve për t'i prekur pjesët e marrosura të trupave. Rendi u vinte fjalëve: përpëlitje, rënkim, dridhje dhe ofshamë.

Vuajtja e dytë qe një përpjekje për ta shpëtuar zemërimin e Rrëfimtari të çasteve të dehura.

Përnjëmend frymëmarrja e tyre ngjante me shpërthimin e të gjitha parandjenjave të grumbulluara përbrenda atij imazhi joshës i cili zbraste magjinë e atyre ditëve të paharruara. Një luhajtje e papritur e syve dukej si një dritë e ndezur në fund të dhomës.

Vuajtja e tretë qe shpërndarë në të gjitha pjesët e universit. Vitet kalonin, ndërsa padurimi zmadhohej sa herë që vinte mërzitja, si terri i pafund i natës.

ÇASTI I TREMBUR

Në ditët që pasuan Rrëfimtari i çasteve të dehura e pa Zanën duke i trembur pëllumbat e bardhë në sheshin e qytetit. Ajo kishte veshur një bluzë të kuqe deri në fund të shpinës, ndërsa lotët i rrëshqisnin teposhtë faqeve. Ishte ndrydhja e radhës në shpirtin e saj.

Për herë të parë e kuptoi se mpirja e shpirtit nuk kishte të bënte aspak me çastin e trembur të pëllumbave dhe asgjë nuk mund të priste më nga zemërimi i pakuptimtë me vetveten. Prandaj marrëdhëniet me iluzionet e shpërfytyruara tashmë i përjetonte si një dëshmi tjetër se gjahtarët e shpendëve mund të ishin edhe njerëz të mirë, edhe pse me gishtin e tyre tregues bënin mëkate.

Rrëfimtari i çasteve të dehura rrëfente krejtësisht ndryshe në tregimet e lumturisë. Në krye të listës aty ishin: fenomenet shpirtërore, ekzistenca e gjërave të shenjta të jetës, sakrificat e pritjes, dëshmia për nostalgjinë e vuajtjes dhe dorëshkrimi i kujtimeve të Gjinnazit të Kijevës.

Thurja e asaj vetmie ngjante me projektionin e ngjarjeve reale, pa pasur ndonjë shpjegim shtesë nëse gjëja më interesante ishte pikërisht bluza e kuqe deri në fund të shpinës, ndoshta edhe një shikim i harlisur i asaj dite.

Kështu nuk kuptohej më asgjë deri në fund. Përveç shikimit.

NJË SY GJUMË

Atë natë mjaullima e një maceje ishte dhjetë herë më e madhe sesa të bërtiturat e shikuesve në stadiumin e qytetit. I dhembte shpirti vetëm pse nuk mund të pajtohej me këtë mjaullimë të përkryer. As me ndrydhjen e errësirës. As me frikën. As me përkatësinë e parëndomtë të mendimeve. Nuk kërkonte shkaqe të tjera, me aq shumë shembuj të magjepsur, ndonëse flaka i dilte shpirtit.

Tingujt që dolën nga veshët e tij sikur ishin shndërruar në trumbetë vetmie. Në vend të jastëkut, pretendimi i kokës tapë tashmë ishte shtrirë mbi dy libra të trashë. Pikërisht aty i gjente fjalët më të duhura për ta kuptuar domethënien e vetmisë apo ndonjë gabim në thurjen e ëndrrave. Çdo përfytyrim tjetër ishte i pabesueshëm, kur realja dhe fantastikja shndërroheshin në diçka që valëzohej si shkumë e bardhë me gjithfarëloj parandjenjash.

– O Zot i Madh, sa mirë që je vetëm merakli i ëndrrave dhe jo edhe i gumit!, – tha Piktori duke tundur kokën në shenjë habie.

PËRMALLIMI

Vajza u nis me e taku Djalin e me çu fjalën n'vend. Atë ditë nuk dashi me ia pa sytë. E le ma me ia puth buzët. Asnjëri sy. As faqet, As buzët. As mjekrën. As mollëzat. As gushën. Ajo atë ditë ishte në dyluftim me vetveten. N'shpirtin e saj kishte vetëm lot e ofshamë.

Mandej u kujtua e u kujtua dhe i ra ndërmend me kurdisë orën. Me u çu kur çohen zogjtë e malit, herët nadje. M'i la sytë. M'i kapërcy ato mure t'nalta. Me u ba Zanë e bukur e vullnetit fisnik t'dashnisë. Me mbërrit me kohë n'gjumit e Djalit. Me u ndihmu andrrave të tij. Me përi puthjen e ngujueme n'shpirtin e vet. Çastin e dashnisë me e marrë me vete. Me u përpjekë me synin e shkruem. Me mbajtë mend hanësi shndrit në natën e lumnueme. Mandej si zgjatet e zgjatet dashnia e fshehtë në ato shtigje që ngajnë me ndonjë pikturë surrealiste.

Apo ashtu me shpirt të përvluem me pyet prapë vetveten se kur vjen përmallimi.

Clarku i parë



Brian HALL

Ata e quanin spastrim të vendbanimeve. E quanin shkatërrim fshatrash.

Fshirje. Nxjerrje me rrënjë. Dhënie shembulli.

Ata nuk thanë: Qëlluar gra dhe fëmijë. Dogjëm pleq gjysmë të verbër në vigvamët e tyre. Ne ia hodhëm çengelën djaloshit që mundahej të hipte në pemë.

William Clark ishte nëntëmbëdhjetë vjeç kur për të parën herë e vrau një indian. Ta skalposh njeriun, e prenë përreth kurorës; ajo ishte pjesa më e rëndësishme, dëshmia, njeriu e ka vetëm një kurorë që ta humbë për vendin e tij. Kur ia ngrehje flokët tingëllonte sikur teshtitje. Indianët i rripnin skalpet me dhëmbë. Ata dukeshin sikur ujë gllabërues. Gjak kishte me shumicë, por lëndimi nuk ishte i rëndë. Njeriu mund të mbijetonte lehtë po qe se nuk e vrisje ndryshe.

Shawonët, dillawayt, mingoesët, maomisët. Ata lëshonin zëra si gjeldetët për të të ngashënyer të hysh në pyll. Afroheshin duke u zvarritur për të të dëgjuar derisa bisedonit, për të të mësuar emrin, kështu që në mëngjes të thërrisnin me emër nga shkurret. I linin mokasinat e tyre në rim, që ti të zbrisje nga kali për t'i ndjekur. Ta ofronin flamurin e bardhë,

pastaj i nxirrnin tomahovkat me t'u dhënë sinjali.

Përshtypjet e Clarkut ishin se një indian e donte skalpin tënd po aq sa të donte të vdekur. Ai mund të ishte i paguar për këtë nga britanikët, të cilët zhvillonin tregti flokësh për ta mbrojtur atë të gëzofit. Po ashtu kishte edhe besëtytni lidhur me marrjen e fuqisë nga i vdekuri. Disa kolonë rruanin kokën që t'i ruanin skalpet e tyre, por indianët kurrë nuk vepronin kësisoj. Edhe kur rruheshin mbrapa dhe përreth, ata gjithmonë e mbanin skalpin. Ky ishte një përcimim për armikun dhe, gjithashtu, një marrëveshje me të. Indianët kishin më shumë marrëveshje në luftë se ç'mund të pandehte njeriu i bardhë. Ata kishin më shumë marrëveshje me armiqtë e tyre në luftë sesa që kishin me fafësin e tyre në paqe.

Clarku ishte katërmëdhjetë vjeç kur erdhi poshtë në Ohio në një barkë me fund të sheshtë, me shokun e tij York dhe me prindërit e motrat e tij. Vëllai i tij George i priste në shtëpinë e tyre të re në Louisville. Vëllezërit Jonathan dhe Edmund do të vijnë më vonë. Vëllai John ishte tashmë i vdekur nga kujdesi i ndjeshëm i britanikëve. Vëllai Richard sapo ishte zhdukur në vendin e indianëve. Në baticat e pranverës mund t'i shihje dy

apo tri barka përgjatë secilës pjesë të gjerë të lumit, të gjitha shkonin në drejtimin e njëjtë. Kentucky ishte parajsë. Njerëzit thoshin: Dheu i Kentuckyit ishte aq i pasur saqë, nëse e mbillje dhe e mirëmbaje tokën, do t'i nxirrje njëzet shinikë misër nga një akër. E mbjellë, por e pa mirëmbajtur, do t'i nxirrje dhjetë shinikë. Por nëse nuk e ke mbjellë e as nuk e ke mirëmbajtur, atëherë do t'i nxirrje shtatë shinikë.

Clark ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç kur për herë të parë doli që t'i luftojë indianët. Kjo pat ndodhur lart në Wabash River, me vëllanë e tij George që komandonte. Por ekspedita ishte dështim. Ishte fushata e fundit e Georgeit. Ai ishte tridhjetë e katër vjeç. Pas kësaj thanë se pinte shumë, por ato qenë gënjeshtër të burrecëve. Pija erdhi më vonë.

Kur Clarku e përmendte vëllanë e tij, ai do të thoshte: ai i kishte vrazat e tij, kujtimet e tij, deklaratat e tij. Për hir të dinjitetit, ai e thoshte atë pa kurrfarë hidhërimi. Por mendimet e tij ishin të hidhura. Dhe në mendimet e tij ishte edhe një fjalë që ai kurrë s'e kishte thënë: vrazat e tij, kujtimet e tij, deklaratat e tij, shishja e tij. George lahej në atë gurrë përditë, dhe përditë mplatej nga një javë.

George kishte vrazë aq shumë indianë saqë nuk mund t'i

numëronte, gjithmonë e thoshte këtë, por atij i kujtohej i pari, njashu siç i kujtohej vëllait të tij të vogël. Williampi shtiu në njeriun nga pema. Lehtësia e heqjes së skalpit, teshtitja e përgjakshme: i kujtohej. Po ashtu, lëkurëkuqja ndoshta trembëdhjetë vjeçe e cila kërceu në përrua, dhe e shtëna që e tronditi Clarkun e që ia theu kurrizin asaj. Ata i shkatërruan tri fshatra, i dogjën arat. I kapën njëzet e dy lëkurëkuqe dhe fëmijë. Të tjerët s'kishin çkahit t'i ktheheshin pos hirave dhe urisë. Ajo qe fushata e kolonel Hardinit, në gusht të vitit 1789. Më pas, Hardini u dërgua si komisionar i paqes te dillawaytë, ndërsa ata e kasapitën.

Ideja e përgjithshme ishte t'i kursenin gratë dhe fëmijët; t'i këmbëjnë me të burgosurit e bardhë apo t'i mbanin si pengje në mënyrë që trimat e tyre të mos bënin ndonjë të ligë. Ndërkaq ata i vrisnin meshkujt. Kjo quhej Lufta Indiane. Por ishte e paparashikueshme. Ndonjëherë ata zinin miq. Kjo do të thoshte se njerëzit që nuk i kishin luftuar indianët nuk e dinin: që ata i njihnin shumicën e këtyre trimave. Indianët bënin miq përtej kufijve. Miqësia ishte religjion për ta. Nëse një indian lidhte miqësi me një të kapur, ai do ta lëshonte atë, edhe pse i liruari do të mund të tregonte se ku gjendeshin fshatrat dhe sa

luftëtarë i kishin indianët. Ndonjëherë kapnin vëllezër. Kjo ishte edhe një gjë tjetër të cilën njerëzit që nuk i kishin luftuar indianët nuk e dinin: që shumë lëkurëkuq ishin të bardhë. Ishte e çuditshme që fëmijët indianë të rritur nga të bardhët ktheheshin në fiset e tyre po qe se kishin rast, por fëmijët e bardhë të zënë nga indianët rriteshin dhe mbeteshin indianë përjetë. Djemtë e arratisur shndërrroheshin në indianë. Prijësi Shawonie, Xhaketa e Kaltër, ishte i bardhë. Ai kishte të veshur një këmishë të kaltër kur ishte kapur gjatë luftës me Anglinë. Ai qe shtatëmbëdhjetë vjeç por, megjithatë, ai u kthye në indian dhe u bë një ndër më të mirët. A do të thotë kjo se njeriu i bardhë ishte më i adaptueshëm sesa i kuqi? A do të thotë kjo se njeriu i bardhë mund ta mundte njeriun e kuq në lojë e tij? Clarku nuk e dinte. Jeta ishte tërheqëse. Ëndrra e djaloshit mbi shkathtësinë e të rrojturit në pyll dhe mbi luftën dhe mbi femrat që i kryejnë të gjitha punët.

Nëse shawonietë ta ngjyrosnin fytyrën me të kuqe, kurseheshe. Nëse ta ngjyrosnin me të zezë, vaj medet. Ata besonin se vdekja që merrte hak një vdekje tjetër e çlironte shpirtin për t'u prehur. Atyre iu pëlqente të të digjnin po qe se kishin nge. Xhandarmëria e Kentuckit i

skalponte të vdekurit e tyre, por në ushtri kjo qe shkruajuar. Clarku hoqi dorë nga kjo gjë qysh pas herës së parë. Por ai kurrë në mendjen e tij nuk mundi ta zbërthejë nëse skalpimi i një indiani do të thoshte më pak respekt për të apo më shumë.

Clark i kishte dëgjuar rrëfimet e vëllait të tij Georgeit kur ishte trembëdhjetë, katërmëdhjetë vjeç. George kishte vlarë më shumë indianë sesa që mund t'i numëronte, mirëpo ai i kishte respektuar ata. Ndërkaq ai nuk i kishte respektuar bashkëkombësit e vet. Kuvendi i Virginias e nderoi atë me shpatën e nderit në të njëjtën kohë kur po ia kundërshtonte deklaratat. Ai e theu shpatën dhe hodhi dorezën në lumin Ohio. Ne mendojmë se ti mund të kesh besim të plotë në drejtësinë dhe zemërgjerësinë e Kuvendit të Virginias. Kështu i thanë kur u largua me vullnetarët e tij në vitin 1778. Fjalët ishin të z. Jefferson.

George tha: Kur trimi i zënë e dinte se ti do ta vrasësh, ai kurrë nuk lutej që t'i falej jeta. Ai ulej qetësisht. Këndonte këngën e tij të vdekjes. George do ta imitonte tingullin, me ritëm si të zemrës dhe akord si të një teli të lirët të violinës. E mbushte dhomën e Clarkëve të ndriçuar nga zjarri me diçka të çuditshme, dhe nëse George ishte i dehur mjaft kjo do ta bënte të qajë.

Njëherë njëri nga njerëzit e Georgeit e goditi me tomahok një të burgosur: arma u ngul në rradakën e burrit dhe përveç kësaj nuk i bëri dëm tjetër. Trimi u zgjat, e nxori me mundim tehun dhe ia dorëzoi sërish ekzekutuesit. Ja pra se si të mposhtin në vdekje, tha George.

Ata e torturojnë të kapurin, tha, ta shohin nëse ai do t'i mposhtë ata. Dhe nëse ai i mposhtë ata, ata mund edhe ta lirojnë.

Por, jo gjithmonë. Asgjë nuk ishte e parashikueshme. Një gjë e dëgjoje shpesh nga të kapurit që ishin arratisur: Indianët grindeshin mes vete se si t'i trajtonin ata. T'i ushqenin apo t'ua nxirrmin zorret jashtë. I kapuri i lidhur për hu rrinte mbi shkarpë dhe dëgjonte një grindje që zgjaste gjithë ditën, që mund të përfundonte me një indian duke e lidhur një tjetër dhe duke e liruar të kapurin e duke e bërë shok. Njerëzit thoshin se ata janë të pabesë, por kjo nuk kishte të bëjë me pabesi. Kështu ndodhte sepse ata nuk kishin rregulla.

Clarkët ishin pronarë të mijëra akërve nga shpërblimet me tokë të Georgit për pjesëmarrjet e tij në luftë. Ata ishin familja më e mirë në Louisville, por ata duhej t'i riorganizonin aksionet e tyre që t'i mbanin huadhënësit e Georgeit në largësi. Clarkët i kishin fituar të gjithat që i kishin, por pronarët mosparaqitës i kishin hektarët më të mirë, dhe kjo qe turp. Zaptuesit erdhën përmes maleve për ta zënë tokën sipas

zakonit të moçëm të Virginias. Shihje çfarë të pëlqente dhe pastaj e bëje një shenjë në dru. Kështu përvetësohej me ndihmën e tomahokut. Pastaj i rrethohe drunjtë, mbjellje misër në tokë dhe tani ishte titullar drithi. Pastaj e ndërtoje një gjysmë kasolle dhe ishte kasollëtar. Pas çdo kodre, përgjatë çdo përroi që pati guxim të rridhte curril në mars, Clarku pa të vdekur mbi trungje, filizimin e farërave. George tha: Në ditën që u hap zyra e patundshmërive në Harrodsburg, u regjistruan kërkesat për një milion e gjysmë akër. Kentucky ishte parajsë, dhe po mbushej edhe më tej. George u desh ta mbante zyrën e patundshmërive të mbyllur që t'ua largojë kolonëve mendjen nga kërkesat e tyre, kështu që mirë të dilnin e të vrisnin indianë. Spastrojini. Kallëzoni qejfin.

Në anën tjetër, indianët kasapitnin. Masakronin. Kur e shpartalluan kolonelin Crawford më '82 e poqën ngadalë në hu. E skalpuan të gjallë dhe i vendosën grumbull prushi mbi kokë. Ndoshta ia jepnin rastin për t'i mposhtur në vdekje, por kjo ishte njësojë neveritëse.

Clark luftoi nën St. Clair nëntë vjet më vonë, kur gjenerali u shpartallua dhe i humbi gjashtëqind njerëz. Dy të tretat e oficerëve të tij. Vështirë se kishte mbetur dikush ta udhëhiqte fushatën e ardhshme. Disa nga burrat e vdekur kishin gojën të rrasur me dhé. Dëshironi tokë, thoshin indianët.

Kasollëtarët iknin nga luftërat e forta, por kur ata zinin indianë, atëherë shihje gjëra që s'do t'i harroje. Vrasja ishte vetëm një gjë.

Ishte e çuditshme se meshkujt do t'i prisnin fytrat e trimave të plagosur, por do t'i shqyenin tejprtej barqet e lëkurëkuqeve. Clarku ia kishte parë mbajtësen e duhanit një njeriu të bardhë të punuar nga qesja e herdheve të një indiani të vdekur. Ai kishte parë frerë kapistrash nga lëkura indiane. Ai kishte parë një njeri duke e mbajtur një shkop dhe çfarë thoshte se ç'kishte në shkop ishin gjenitalet e një lëkurëkuqeje.

Kjo nuk ishte ide e përgjithshme. Indianët gjithmonë shpartalloheshin dhe iknin nga mbushjet e bajonetave. Ata nuk luftonin në atë mënyrë, të grumbulluar. Mund të thuash se nuk ishte një nga marrëveshjet e tyre. Ata me siguri mendonin se kjo nuk ishte trimëri. Nuk e kishin idenë çfarë trimërie të duhej të qëndroje në atë linjë. Bajonetat ndihmuan fitoren e Fallen Timbers. Clarkut i kujtoheshin hithrat në atë fushatë. Të lartë deri në bel dhe me milje në gjatësi. Trupi i tij u përmdez si një tallaz acidi. Atij i kujtoheshin manaferrat e ëmbla të një fushate tjetër, kur furnizimet u harxhuan.

Shawoniet e quanin korrikun Hëna Manaferrë. Ata e quanin

majin Hëna Dredhëz. Vendi Ohio ishte një parajsë frutash. Djemtë dilnin me vrap të luanin Indian dhe jetonin me manaferra. I merrnin tri gra. A nuk do të jetoje edhe ti ashtu?

Atij i kujtohej fushata kur intendentit iu kishte dërguar shala për elefantë në vend të kuajve. I kujtohej kur i morën farkat pa asnjë kudhër. Atij i kujtohej shpartallimi i St. Clairit, kasollëtarët arratiseshin të parët e mandej ushtarët, dhe gratë e kampit duke u çjerrë pas tyre. Ruaju befasisë, i kishte thënë Washingtoni St. Clairit. Ndoshta ai e ka ditur se kishte punë me njeriun që nuk i zihej besë, sepse ai i kishte thënë përsëri: ruaju, mbi të gjitha, befasisë.

Vëllai i tij, George, në karrierën e tij të gjatë, asnjëherë nuk ishte befasuar. Nga indianët, natyrisht. Whiskey ia kishte molepsur aftësitë mbrojtëse përditë e më shumë. Ulej pranë zjarrit dhe

shfrynte kundër vendit të tij mosmirënjohës dhe bisedonte për shpërnguljen e tij në Spanish Louisiana dhe qante sikur vashë, këngën e tij të vdekjes. Aventurat e tij përfunduan. Williami udhëtonte me mijëra milje, i luftonte proceset gjyqësore, zgjidhte koncesione dhe sa herë që kthehej e gjente vëllanë e tij të madh më të paktë. Georgei thahej sikur mollë e thartë. Ata ishin familja më e mirë në Louisville dhe e kishin këtë lemeri në shtëpi.

Ndonjëherë një armik i vjetër indian e vizitonte, dhe George dhe trimi do të përqafoheshin dhe do të deheshin dhe do të rrëmbeheshin. Dobësia që kishte për whiskey ishte një besëlidhje me njeriun e kuq. Kurse William nganjëherë kujtonte se kishte lidhur besë me ligështinë. Ethet malarike dhe lëngatat për të ishin si mallkim gruaje, gjithnjë i ktheheshin. Përderisa fshatrat Shawonie, Dillaway,


Maomi, iu rrëzuan lisë, etheve të tëmthave, rrufës. Këto nuk ktheheshin. A ishte njeriu i bardhë më i qëndrueshëm?

Një gjë Clarku e dinte. Njeriu i kuq i Mississippit lindor kishte mbaruar.

Ruaju, mbi të gjitha, befasisë. St. Clair u befasua në një agim të ftohtë nëntori. Clarku ishte njëzet e një vjeç, luan, dhe ishte vonuar të ikë nga fusha. Atij i kujtohej: kishte shikuar mbrapa dhe e kishte parë tokën e mbuluar me njerëz të vdekur, secili i shenjuar me nga një pupël të bardhë duke u ngritë në rezet e para. Kokat e tyre të skalpuara avullonin.

(Fragment nga romani "I Should Be Extremely Happy in Your Company, A novel of Lewis and Clark", Penguin Book, 2003)

Përktheu nga anglishtja:
Fadil BAJRAJ



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova mbylli turneun e UEFA-s me tri fitore

PRISHTINË, 12 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës U16 për vajza ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e tretë në turneun "UEFA Development"

që prej 7 deri më 12 mars u mbajt në Kamëz nën organizim të Federatës Shqiptare të Futbollit. Kësaj, vajzat dardane dolën më të

suksesshmet në këtë turne, me tri fitore. Në ndeshjen e parë fituan ndaj Andorrës, më pas kundër Shqipërisë (pas penalltive) dhe kundër

Moldavisë, me rezultat 6:2. Nga dy gola i shënuan Riga Kallaba dhe Olsa Maqestena, derisa Liza Hoxha dhe Loela Ahmeti kontribuuan me nga një gol.



Kampioni fiton kundër prizrenasve, Rahoveci arrin fitoren e katërt

SUHAREKË, 12 MARS - Golden Eagle Ylli ka mundur Ponte Prizrenin me rezultat 81:68 (22:10, 15:23, 22:19, 22:16), në javën e 25-të të Prince Caffè Superligës. Vendasit e nisën për mrekulli me një seri prej 15:4 dhe ishin bindës në çerekun e parë, duke e fituar 22:10. Megjithatë, prizrenasit nuk u dorëzuan dhe në periudhën e dytë ngushtojnë shifrat, dhe madje kalojnë në epërsi 27:30, por therandasit me një seri të suksesshme në fund shkuan në pushim me rezultat 37:33. Por, në periodën e tretë, kampionët sërish u shkëputën në 14 pikë epërsi, 51:37, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 59:52. Basketbollistët e Prizrenit në dhjetë minutat e fundit

arritën të rikthehen, ku barazuan shifrat në 63:63, megjithatë, nuk arritën të bëjnë më shumë dhe Ylli triumfoi 81:68. Më të mirët e Yllit ishin Chris Harris me 21 pikë e 18 kërcime dhe Gëzim Morina me 15 pikë e 12 kërcime, ndërsa te Ponte Prizreni u dalluan Meriton Ismaili me 15 dhe Muhamedali Janjeva me 13. Therandasit kanë 18 fitore e shtatë humbje, ndërsa prizrenasit shtatë fitore e 18 humbje. Rahoveci ka regjistruar fitoren e katërt këtë edicion, duke mundur Bashkimin me rezultat 101:91 (29:20, 20:20, 25:24, 27:27), në kuadër të javës së 25-të të Prince Caffè Superligës. "Vreshtarët" kanë edhe 21 humbje, ndërsa prizrenasit kanë



11 fitore e 14 humbje. Vendasit e nisën shumë mirë me epërsi prej dhjetë pikësh 16:6, ndërsa më pas e shtuan atë në 22:10, kurse çerekun e parë e fituan 29:20. Periudha e dytë ishte tërësisht e

barabartë, me vendasit që u mundonin të ruanin epërsinë dhe mysafirët që tentonin rikthimin, ku pjesa e parë përfundoi 49:40. Prizrenasit e nisën më mirë periudhën e tretë,

duke barazuar shifrat në 61:61, por "Vreshtarët" sërish u shkëputën, ku shifrat pas 30 minutash ishin 74:64. Në dhjetë minutat e fundit, Rahoveci nuk e lëshoi epërsinë dhe triumfoi 101:91. Te Rahoveci u dalluan Jack Pagenkopf me 20 pikë, gjashtë kërcime e gjashtë asistime, Edmond Kryeziu me 24 pikë e katër kërcime dhe Gary Blackston me 17 pikë e tetë kërcime, ndërsa më i miri te Bashkimi ishte Daniel Lekndreaj me 16 pikë e 13 kërcime. Peja ka vazhduar me formë të mirë pas emërimit të trajnerit të ri, ku kësaj radhe mundi bindshëm Vëllaznimin 127:80 (41:18, 28:23, 33:23, 25:16), në xhiron e 25-të të Prince Caffè Superligës.

Llapi mposhti kampionin, Drita fiton derbin ndaj Gjilanit

Podujevë, 12 mars - Drita është rikthyer në krye të renditjes në Albi Mall Superligë, pasi ka fituar në derbin e javës së 25-të nga rivali lokal, Gjilani, me rezultat 1:0, derisa lideri i deritashëm Ballkani pësoi humbje nga Llapi në Podujevë. Golin e vetëm në këtë ndeshje, e shënoi mesfushori Blend Baftiu në minutën e 43-të. Ndërkohë, Llapi ka arritur ta mposhtë kampionin në fuqi, Ballkanin, me rezultat 3:2. Festim Alidemaj (5'-pen), Bekim Maliqi (71') dhe Bianor Neto (76') shënuan për Llapin, derisa për portokallezintë realizuan Albion Rrahmani (53') dhe Meriton Korenica (63'). Në anën tjetër Malisheva ka shënuar fitore si mysafire në duel me Prishtinën, me rezultat 2:1, me golat e Sobowales (8') dhe Hazrollajt (81'), derisa golin e vetëm për prishtinasit e realizoi Shefiti (83').

Ndërkohë, dje Ferizaj shënoi fitore si mysafir në përballje me Trepçen'89 (1:0), derisa Dukagjini mposhti Drenicën (2:0). Ferizaj ka marrë një fitore të madhe në udhëtim te Trepça '89 me rezultat minimal 0-1. Ka qenë një ndeshje shumë e luftuar nga të dyja skuadrat, por që gjatë 90 minutave u pa vetëm një gol. Ishte minuta e 19-të e ndeshjes kur u realizua goli i vetëm në këtë sfidë me mysafirët që bënë një aksion fantastik. Filip Gligorov asistoi bukur te Mateo Panadic i cili nga afërsia realizoi për 0-1. Trepça '89 deri në fund të ndeshjes kërkoi me ngulm golin e barazimit, por një gjëje të tillë nuk ia arriti dhe Ferizaj arkëtoi tre pikë të arta nga kjo përballje. Ferizajasit me këto tre pikë ngritën në pozitën e shtatë në tabelë me 27 pikë, derisa lënë Trepçen '89 një vend më poshtë me një pikë më pak. Ndërkohë



Dukagjini ka marr fitoren e dytë radhazi në Albi Mall Superligë, teksa ka mposhtur Drenicën me rezultat të pastër 2-0. Skuadra e udhëhequr nga Armend Dallku ka mposhtur një kundërshtar direkt për mbetjen në elitë dhe tre pikët e fituara sot i japin komoditet në tabelë. Ishte minuta e 12-të e ndeshjes kur Otto John kaloi klinasit në epërsi falë një goli të realizuar brenda

zonës së rreptësisë për 1-0. Me epërsinë minimale të vendasve përfunduan 45 minutat e para të kësaj sfide. Edhe pjesën e dytë klinasit e nisën më mirë, kur vetëm pas dy minutash shënuan golin e sigurisë. Ishte mbrojtësi anësorë Arbër Shala që u përkujdes për 2-0. Deri në fund Dukagjini u mbrojt mirë dhe arritën fitoren e dytë radhazi, derisa Drenica pëson humbjen e

SUPERLIGA	
Prishtina - Malisheva	1-2
Drita - Gjilani	1-0
Llapi - Ballkani	3-2
Trepça '89 - Ferizaj	0-1
Dukagjini - Drenica	2-0
Tabela	
1. Drita	51 pikë
2. Ballkani	50
3. Gjilani	39
4. Prishtina	32
5. Dukagjini	32
6. Llapi	32
7. Malisheva	28
8. Ferizaj	27
9. Trepça '89	26
10. Drenica	23

dytë të njëpasnjëshme. Me tre pikët e fituara, Dukagjini ngritën në pozitën e pestë në tabelë me 32 pikë, derisa Drenica mbetet e fundit në tabelë me 23 sosh.


Kosova mposhtet sërish nga Bosnja

PRISHTINË, 12 MARS - Lufta e madhe në mbrojtje nuk mjafton për të fituar pikë në Tuzlla ndaj Bosnjë-Hercegovinës. Të dielën mbrëma, Përfaqësuesja e

Kosovës në hendboll pësoi me rezultat 25:18. Na kushtojnë gabimet e shumta në sulm, përkatësisht humbja e shumë gjuajtjeve nga pozita të mira. Nuk mjaftojnë as 15

pritjet e Haris Berishës. Në pjesën e dytë jemi afuar deri në një gol, por pa mundur të dalim në avantazh. Në eliminatorët për "Euro 2024" luajmë edhe dy ndeshje, në

shtëpi me Malin e Zi dhe në udhëtim me Slloveninë. FHK-ja falënderon shikuesit shqiptarë në palestër për përkrahjen dhe lojtarët për angazhimin





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.28/2023 me nr. të protokollit 02-07/28, KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS)

Titulli: Udhëheqës i Njësisë Teknike 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-5-2023

I raporton: Drejtorit të Operativës

Niveli i pagës: Niveli IV

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK-së SH.A

Detvrat dhe Përgjegjësitë

Udhëheqësi i Njësisë Teknike ka për detyrë të bëjë:

- Udhëheqësi i Njësisë menaxhon me stafin teknik duke përfshirë, automekanikët dhe drejtuesit/manipuluesit e makinerisë së rëndë.
- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me angazhimin dhe punën e makinerisë së KMDK-së;
- Planifikon mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të makinerisë duke udhëzuar teknikët dhe ngasësit e makinerisë me qëllim të parandalimit të defekteve;
- Këshillon, inspekton dhe trajnon teknikët dhe ngasësit e makinerisë;
- Harton specifikat teknike për tenderët për makinerinë e rëndë;
- Hulumton tregun për asetet (makineri të rëndë) dhe pjesë rezervë për KMDK-në;
- Bën Inspektimin e rregullt, të makinerisë së KMDK-së;
- Jep mendime profesionale dhe përcakton defektet në makinerinë e KMDK-së;
- Si dhe punë shtesë që i delegohen nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe sipas nevojave të KMDK-së;
- Udhëheqësi i Njësisë Teknike në bashkëpunim me Udhëheqësin e Sektorit të Inxhinierisë si dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Deponive bashkërendon aktivitetin për mirëmbajtjen e peshoreve/urë matëseve, pompave të ujit, rezervarët e derivateve, gjeneratorët si dhe të pjesëve të tjera teknike që janë në shërbim të operativës.
- Udhëheqësi i Njësisë Teknike për punën e vet i përgjigjet Drejtorit të Operativës.

Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diploma universitare, Fakulteti i Makinerisë;
- Minimum 2 vjet përvojë pune për makineri të rëndë;

Aftësitë krvesore

- Njohuri të dëshmuara në lëmin e riparimit dhe servisimit të makinerisë;
- Njohja e punës me kompjuter duke përfshirë: MS-Office dhe programet tjera relevante sa i përket fushës së makinerisë;
- Njohuri të gjuhëve që janë në përdorim zyrtar në Kosovë, përparësi të jetë njohja e Gjuhës angleze apo Gjermane;
- Aftësi për të prezantuar rezultatet e analizave gjatë punës.

Titulli: Vozitës Personal i KE-së 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-6-2023

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: VIII

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK-së SH.A

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Drejton automjetin dhe kujdeset mbi rregullsinë dhe mirëmbajtjen e rregullt vijuese të automjetit;
- E mban evidencën e shpenzimeve të karburantit, lubrifikimit të vajit dhe materialit tjetër;
- E mban evidencën e orëve të punës së automjetit;
- E kontrollon gjendjen e automjetit;
- I evidenton defektet e vogla dhe bën ndërrimin e disa pjesëve;
- Mban evidencën mbi qarkullimin dhe shfrytëzimin e automjetit, kontrollin preventiv dhe riparimin, harxhimin e gomave, skadimin e regjistrimit etj;
- I arsyeton shpenzimet për karburante;
- Kryen edhe punë tjera të kërkuara nga KE;
- Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlidhen me pozitën e caktuar.
- Për punën e tij i përgjigjet KE.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës së mesme,
- Aftësitë krvesore**
- Të posedojë patentë shofer të kategorisë përkatëse;
- Përvojë pune në profesion, e preferueshme;

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 13.03.2023 deri me datën 27.03.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

NJOFTIM PËR KONTRATË

(Sherbim)

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 23 013 221
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: Shërbimet e pastrimit të objekteve të BQK-së

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Garibaldi" nr. 33, 10000 Prishtinë.

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të lirë" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

- V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:
- V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 17.03.2022 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org
- Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 17.03.2022 ora 14:00
- V.3 Sigurimi i tenderit: 1,000.00 € (një mijë euro) për periudhë valide prej 90 dite.
- V.4 Sigurimi i kontratës: n/a
- V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:
Data: 21.03.2023, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
www.bqk-kos.org



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrište, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupcima zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. KMDK SHA sa br. 28/2023 sa br. protokola 02-07/28 KMDK SA saopštava:

JAVNI KONKURS

(ZA POPUNJAVANJE RADNOG MJESTA)

Zvanje: - Rukovodilac tehničke jedinice 1 (jedna pozicija)

Referentni broj: ZP/KJ-5-2023

Izveštava: Direktor operacija

Nivo plata: Nivo IV

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti

Rukovodilac tehničke jedinice odgovoran je za:

- Voda jedinice upravlja tehničkim osobljem uključujući automehaničare i vozači/operateri teških mašina.
- Mjesečno i godišnje planiranje vezano za angažovanje i rad mehanizacije KMDK-of;
- Planira redovno održavanje i servisiranje mašine upućivanjem tehničara i Pogoni strojeva u svrhu sprječavanja kvarova;
- Savjetuje, pregleda i obučava tehničare i vozače mašina;
- Izrađuje tehničke specifikacije za tendere za tešku mehanizaciju;
- Istražuje tržište sredstava (teške mehanizacije) i rezervnih dijelova za KMDK;
- Vršiti redovne preglede mehanizacije KMDK;
- Daje stručna mišljenja i utvrđuje kvarove na mašinama KMDK;
- Kao i dodatni poslovi koje delegira neposredni rukovodilac a prema njegovim potrebama KMDK;
- Rukovodilac tehničke jedinice u saradnji sa rukovodiocem sektora za inženjering as te u saradnji sa upravnicima deponije koordinira aktivnosti održavanja

vaga/mjernih mostova, pumpi za vodu, rezervoara derivata, generatora kao i ostali tehnički dijelovi koji su u službi operative.

- Rukovodilac tehničke jedinice za svoj rad odgovara operativnom direktoru.

Kvalifikacije i radno iskustvo

- Fakultetska diploma Mašinskog fakulteta;

- Minimalno 2 godine radnog iskustva za tešku mehanizaciju;

Ključne vještine

- Dokazano znanje iz oblasti popravke i servisiranja mašina;
- Poznavanje rada na računaru uključujući: MS-Office i druge relevantne programe kao što su i pripada oblasti mašina;
- Poznavanje jezika koji su u službenoj upotrebi na Kosovu, poznavanje jezika je prioritet engleski ili njemački;
- Sposobnost prezentovanja rezultata analiza tokom rada.

Titula: - EC lični vozač 1 (jedna pozicija)

Referentni broj: ZP/KJ-6-2023

Izveštava: Glavni izvršni direktor

Visina plate: VIII

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja vozilom i brine o njegovoj ispravnosti i redovnom održavanju vozilo;
- Vodi evidenciju troškova goriva, ulja za podmazivanje i drugog materijala;
- vodi evidenciju o radnom vremenu vozila;
- Provjerava stanje vozila;
- identifikuje male nedostatke i zamenjuje neke delove;
- Vodi evidenciju o prometu i korištenju vozila, preventivnu kontrolu i popravka, habanje guma, rok registracije itd.;
- opravdava troškove goriva;
- obavlja i druge poslove na zahtjev EK;
- Obavlja i druge dodatne poslove u skladu sa važećim zakonima u vezi sa dodijeljenim položajem.
- EK je odgovorna za njegov rad.

Kvalifikacije:

- Diploma srednje škole

Ključne vještine

- da posjeduje vozačku dozvolu odgovarajuće kategorije;

- Radno iskustvo u struci, poželjno;

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrište. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija

- Životopis,

- Diploma,

- sertifikate o kvalifikacijama i obuci,

- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.

- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 13.03.2023. do 27.03.2023. godine, 08:00-16:00.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Urgjentisht kërkohet një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshohet banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshohet lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshohet banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

